



**KËSHILLI PARNOR
PËR DIALOGUN NDËRFETAR**

MESAZH PËR PËRFUNDIMIN E RAMAZANIT
'Id al-Fitr 1432 H./2011 A.D.

*Të krishterë e myslimanë:
të promovojmë përmasën shpirtërore të njeriut.*

Qytet i Vatikanit

Të dashur Miq myslimanë,

1. Përfundimi i muajit të Ramazanit i krijon Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar rastin e dëshiruar t'ju drejtojë urimet më të përzemërta që flijimet e bëra bujarisht gjatë këtij muaji, të japin frytet e shpresuara shpirtërore.
2. Këtë vit, na u duk e arsyeshme të theksojmë temën e përmasës shpirtërore të njeriut. Është një realitet me rëndësi të dorës së parë, si për të krishterët, ashtu edhe për myslimanët, posaçërisht përballë sfidave të materializmit e të shekullarizimit. Lidhja e çdo njeriu me trashëndencën nuk është fryt i rrethanave të historisë. Është e shkruar në vetë natyrën njerëzore. Ne nuk besojmë rastësisht, por jemi të bindur se Zoti na prin në udhën tonë. E këtë e provojmë çdo ditë.
3. Si të krishterët e myslimanët, pavarësisht nga ndryshimet, e njohin dhe mbrojnë dinjitetin e njeriut, me të drejtat e detyrat e tij. Të dyja palët mendojnë se arsyeja e liria janë dhurata po aq të çmuara që duhet t'i inkurajojnë besimtarëve, t'i pranojnë këto vlera, që i kemi të përbashkëta, sepse mbështetën mbi të njëjtën natyrë njerëzore.
4. Ja, pra, pse të dyja palët kemi të njëjtin shqetësim: t'ua transmetojmë këto vlera njerëzore e morale breznive të reja. Na takon ne t'i ndihmojnë të zbulojnë ç'është e mirë e ç'është e keqe, t'u tregojmë se ndërgjegjja është shenjtërore, që duhet respektuar; se përmasa shpirtërore i bën njerëzit më të përgjegjshëm, më solidarë e më të gatshëm për t'i shërbyer së mirës së përbashkët.

